



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:204998

Datë: 11.04.2024

Numri i dokumentit: 05563849

**C.nr. 2817/23**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i përgjithshëm** – Divizioni civil, me gjyqtarin Besnik Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.T nga P, dhe R.M nga J të cilët i përfaqëson sipas autorizimit av. D.K nga P kundër të paditurës K.R.H me seli në P Rr..... nr.156 të cilën e përfaqëson E.B avokat në P, me bazë juridike anulim i vendimit dhe kompensim i pagave, vlera e kontestit 13.723.33 euro, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqës, pas seancës se shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 27.03.2024, ndërsa me datë 11.04.2024, përpiloj këtë:

**A K T G J Y K I M**

**APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia** alternative e paditësve A.T dhe R.M kundër të paditurës K.R.H me seli në P me të cilën kanë kërkuar që të:

- I. ANULOHEN** në Tërësi vendimet e të paditurës me nr.954/23 dhe 955/23 të datës 18.08.2023.
- II. DETYROHET** e paditura K.R.H me seli në P, që në emër të dyfishit të pagave të papaguara për periudhën nga momenti i marrjes së vendimit 18.08.2023 deri me datë 31.12.2023, për shkarkim nga pozita e punës, secilit veç e veç tia kompensoj:
  - a) Agron Tigani** t'ia kompensoj dyfishin e pagave të papaguara në shumë neto prej 6,959.15 euro; Në emër të kontributit pensional 788.40 euro të cilat duhet të transferohen në trustin e kursimeve pensionale në emër të paditësit A.T; Në emër të tatimit në burim 530.78 euro, të cilat duhet transferuar në Administratën Tatimore të Kosovës..
  - b) Rasim Maloku** t'ia kompensoj dyfishin e pagave të papaguara në shumë neto prej 6,764.18; Në emër të kontributit pensional 765.60, të cilat duhet të transferohen në Trustin e Kursimeve pensionale në emër të paditësit R.M; Në emër të tatimit në Burim 509.54 euro, të cilat duhet transferuar në Administratën Tatimore të Kosovës.
- III. DETYROHET** e paditura K.R.H me seli në Pejë, që paditësve A.T dhe R.M kërkesat nga pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia kompensoj me kamatë ligjore prej 8 % në vite, nga data e paraqitjes së padisë (27.09.2023) gjerë në pagesën definitive, e të gjitha këtij si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi në afate prej 7 ditësh, nga dita e pranimit e nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- IV. RFUZOHET** kërkesa që të detyrohet e paditura K.R.H me seli në P, që paditësve A.T ti kompensoj në emër të sigurimit shëndetësor shumën prej 138.75 euro dhe kërkesa që

paditësit R.M ti kompensoj në emër të sigurimit shëndetësor shumën prej 138.75 euro, dhe që në emër të shërbimeve shëndetësore dhe terapisë ti paguaj shumën prej 312.66 euro si e pa bazuar.

- V. REFUZHET** kërkesa alternative e paditësve A.T dhe R.M kundër të paditurës K.R.H me seli në Pejë, me të cilën kanë kërkuar që të DETYROHET e paditura “KRU HIDRODRINI” me seli në Pejë, që paditësin A.T ta kthej në vendin e punës, inxhinier për mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit dhe planifikimit të projekteve, kurse paditësin R.M ta kthej në vendin e punës si Kordinator i ujit të pafaturuar dhe raportimit. DETYROHET e paditura “KRU H”, me seli në P, që në emër të pagave të porealizuara nga momenti i marrjes së vendimit për shkarkim nga pozita e punës deri sa ekzistojnë kushtet ligjore, paditësve secilit veç e veç tia kompensoj: 1.A.T tia kompensoj pagat e porealizuara në shumën neto prej 3,479.57 euro; Në emër të kontributit pensional shumën në vlerë prej 394.20 euro, të cilat duhet të transferohen në Trustin e kursimeve pensionale në emër të paditësit A.T; Në emër të sigurimit shëndetësor 138.75 euro; Në emër të tatimit në Paga shumën në vlerë prej 265.39 euro të cilat duhet transferuar në Administratën Tatimore të Kosovës. 2.R.M tia kompensoj pagat e porealizuara në shumë neto prej 3,382.09 euro; Në emër të kontributit pensional shumën në vlerë prej 382.80, të cilat duhet të transferohen në Trustin e kursimeve pensionale në emër të paditësit R.M; Në emër të sigurimit shëndetësor 138.75 euro; Në emër të shërbimeve shëndetësore dhe terapisë 312.66 euro; Në emër të tatimit në paga shumën në vlerë prej 254.70 euro të cilat duhet transferuar në Administratën Tatimore të Kosovës.
- VI. DETYROHET** e paditura ”KRU H”, me seli në P, që paditëses A.T dhe R.M, t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 1.990.80 euro, e të gjitha këto t’i përmbushë në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcenim të përmbarrimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi, kundër të paditurës, me bazë juridike anulim i vendimit dhe kompensim i pagave, vlera e kontestit 13.723.33 euro, e të precizuar me parashtrësën e datës 01.13.2024.

I autorizuari i paditësve me padi, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: Gjatë shqyrtimit është vërtetuar se të dy paditësit kishin marrëdhënie pune me të paditurën në afat kohorë mbi dhjetë vite, e që në përputhje me ligjin e punës të aplikueshëm në Kosovë, të njëjtit kanë pasur kontratë pa afat, neni 10 paragrafi 5 i Ligjit të punës i cili parasheh që “Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore”), dhe se pas përfundimit të kontratës në mars të vitit 2023 nga ana Bordit të Drejtorëve paditësi i parë është sistemuar si Inxhinier i Njësisë Operative në Deçan, më pas nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv sistemohet në sektorin e kanalizimit si Inxhinier për mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit dhe planifikimit të projekteve. Ndërsa të

paditurit të dytë, pas përfundimit të kontratës në prill të vitit 2023 në pozitën e Zyrtares Kryesore Financiare, nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv i është ofruar pozita e re e punës si Koordinator i Ujit të Pafaturuar dhe Raportim. Sistemimi i të dy të paditësve në ana të Kryeshefit Ekzekutiv nuk është bërë konform dispozitave ligjore të Ligjit të Punës dhe Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe po ashtu nuk është bërë konform kompetencave statutore të tij nga neni 16 paragrafi 3 pika 3.3 të Statutit të "KRU H" SH.A. Pas mbledhjes së Bordit të Drejtorëve të datës 16.06.2023, me datë 18.08.2023 për paditësin e parë është nxjerrë kundërligjshëm vendimi nr.954/23 me të cilin është anuluar vendimi nr. 701/23 dhe kontrata e punës me numër 702/23 e datës 30.06.2023, dhe në të njëjtën datë për paditësin e dytë është nxjerrë kundërligjshëm vendimi nr. 955/23 me të cilin është anuluar vendimi 750/23 dhe është ndërprerë kontrata e punës nr. 751/23 e datës 12.07.2023, me arsyetim kinse për pozita të lartçekura nuk është hapë konkurs konform ligjit. Vendimet e Kryeshefit Ekzekutiv me nr. 954/23 dhe 955/23 të datës 18.08.2023 janë nxjerr me zbatim të gabuar të drejtës materiale, përkatësisht nenit 17 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit të Punës siç është cituar në padi. Po ashtu shkelje tjetër nga ana e të paditurës është bërë me rastin e marrjes së vendimit për ndërprerje dhe me mos paralajmërimin me shkrim për ndërprerjen e kontratës e cilës është e rregulluar me Ligjin e Punës, respektivisht me nenin 71 paragrafi 1.3 të Ligjit të Punës të cilën e paditura është e obliguar ta respektojë, ka dështuar ta njoftoj me paralajmërim prej 60 ditë kalendarike apo pa ndonjë vërejtje për përmirësimin e performancës. Ndërsa argumentimi i palës se paditur se Kryeshefi Ekzekutiv nuk ka pasur bazë ligjore për nxjerrjen e vendimeve për sistematizimin e paditësve në vendet tjera të punës dhe është dashur të hapë konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon marrëdhënie pune është i paqëndrueshëm sepse paditësit kanë qenë në marrëdhënie pune me kohë të pacaktuar, po ashtu vendimi i sistemimit të tyre është edhe kundërtë në provat e dorëzuara në lidhje me sistemimin nga ana e të paditurës të punësuarve F.Ç, M.K dhe M.K. E paditura nuk ka sjellur asnjë dëshmi për procedurën e ndjekur të riorganizimit të brendshëm të saj. Mungesa e një procedure të tillë e bën të kundërligjshëm çdo veprim të të paditurës në raport me degradimin e paditësve në marrëdhënie të punës. Argumentet e të paditurës se herë është bërë sistemim i punëtorëve herë nuk ka pasur bazë ligjore për këtë procedurë pos për shpallje të konkursit janë kundërtë me vet veten dhe me gjitha provat e administruara materiale. Është vërtetuar gjatë këtij gjykimi se Vendimet e Kryeshefit Ekzekutiv, nr. 954 dhe 955 të datës 18.08.2023 janë nxjerrë me zbatim të gabuar të drejtës materiale dhe përkatësisht nenit 17 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit të Punës e cila shprehimisht përcakton "Në rast të nevojës për ristrukturim apo organizim të ri të punës, i punësuarit në pajtim me Kontratën e Punës mund të sistemohet në vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes profesionale, aftësisë së tij dhe nivelit të njëjtë të pagës, në pajtim me Kontratën e Punës. 3. 1 punësuarit sipas nevojës mund të sistemohet në punë nga një vend në një vend tjetër, tek i njëjti punëdhënës në pajtim me Kontratën e Punës, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën Kolektive" dhe nenit 21 të Rregullores së brendshme të "KRU H" e cila përcakton ashtu siç është përshkruar në dispozitat e Ligjit të Punës nga neni 17. Në kuptim të gjendjes faktike fillimisht është argumentuar se duke pasur parasysh paditësit fillimisht kanë qenë pjesë e stafit të "KRU H" ku paditësi parë nga viti 2004 deri në vitin 2007 dhe pastaj nga viti 2007 deri në vitin 2023 si Kryeshef Ekzekutiv, konsiderohet që është në marrëdhënie pune si punëmarrës me punëdhënësin "KRU H". Ligji i Punës dhe Rregullorja e brendshme e "KRU H" parasheh se i punësuarit në pajtim me kontratën e punës dhe aktet e brendshme të punëdhënësit mund të sistemohet në vend tjetër, apo nga një

vend në vend tjetër tek i njëjti punëdhënës, pa pasur nevojën e shpalljes së ndonjë konkursi. Përveç të lartcekurave Ligji për Ndërmarrjet Publike në dispozitat e saj parasheh hapjen e konkursit publik vetëm për marrjen e punëtorëve të rij në pozitat e zyrtarëve të lartë të cilët janë (i) Kryeshefin Ekzekutiv, (ii) Zyrtarin Kryesor Financiar dhe të Thesarit, (iii) Këshilltarin e Përgjithshëm/Sekretarit e Korporativ dhe (iv) një Zyrtar për Auditim të Brendshëm po ashtu shpenzimet procedurale i kërkojmë në mënyre të specifikuar.

I autorizuari i të paditurës me përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: mbesim prapa pretendimeve të thëna nga seancat kaluar. E kundërshtojmë në tërësi kërkesëpadinë e paditësve pasi që njëjta nuk është bazuar në ligj dhe në prova të mjaftueshme. Paditësit kanë qenë në marrëdhënie pune me të paditurën deri me dt. 24.03.2023 në pozita të larta drejtuese si krye shëf ekzekutiv dhe zyrtar i lartë financiar dhe në momentin kur i është skaduar kontratat dhe me konkursin publik të njëjtit nuk kanë mundur të rizgjidhen në këto pozita, dhe krye shëfi i ri duke e parë nevojën për punëtor për staf në ndërmarrjen i sistemon të njëjtit në pozita të reja duke iu lidhe kontrata në kohe të caktuar deri me dt. 31.12.2023. Mirëpo bordi i drejtorëve si organi më i lartë i ndërmarrjes në mbledhje e pa zakonshme para marrjes së vendimit për caktim e zyrtarëve të lartë në pozita të larta, nuk është hapur konkurs i ri siç e sheh ligji i punës neni 8 dhe me vota unanime e rekomandon shëfin ekzekutiv që të i shfuqizon vendimet e marra dhe të i anulon kontrata me arsyetimin se nuk është hapur konkursi, andaj si palë e paditur ndërmarrja e kundërshtojmë nga aspekti i bazës e po ashtu edhe nga lartësia e dëmit, nëse i është bërë dëm paditësve atëherë dëmi është shumë më i vogël sesa në precizimin e kërkesëpadiisë, duke u lidhë në nenin 71 të Ligjit të Punës, punëdhënësi mund të ndërpret kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftim prej 30 ditësh dhe dështimet për të ia njoftuar nga punëdhënësi ia jepte drejtën të punësuarit për zgjatjen e afatit prej 30 dite kalendarike në pagë shtesë, andaj i propozojmë gjykatës të refuzoj kërkesëpadiisë dhe të detyroj të paditurën që të bëjë pagesën e shpenzimeve të procedurës për përpilimin e përgjigjes në padi shumen 312 euro, dhe përfaqësimin në 3 seanca nga 405 euro, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Gjykata në këtë çështje juridike – kontestimore më qëllim të vërtetimit të plotë të gjendja faktike, sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat siç janë: vendimi me nr. protokollin 954 i dt. 18.08.2023 marrë nga H për A.T, kontrata e punës me kohë të caktuar me nr, protokollin 702 e dt. 30.06.2023 për A.T, kontrata e punës me nr protokollin 9 e dt. 23.03.2020 për Agron Tiganin, pasqyra e llogarisë së Trustit për A.T, ankesa me nr. 1014 e dt. 28.08.2023 e ushtruar nga Agron Tigani, vendimi me nr. protokollin 955 i dt. 18.08.2023 marrë nga H. për R.M, kontrata e punës me kohë të caktuar me nr, protokollin 751 e lidhur në mes të H dhe R.M, kontrata e punës me nr protokollin 10 e dt. 23.03.2020 për R.M, pasqyra e llogarisë së Trustit për R.M, ankesa me nr. 1013 e dt. 28.08.2023 e ushtruar nga R.M, rekomandimi me nr. protokollin 42 i dt. 16.08.2023, ekspertiza financiare e punuar nga V.L e dt. 01.01.2024, pasqyra e kalkulimit të pagave për Agron Tiganin, pasqyra e kalkulimit të pagave për R.M, raporti mjekësor për R.M dt. 17.10.2023 bashkë me kupon fiskal, raporti Specialistik për R.M bashkë me kupon fiskal, raporti Specialistik për R.M bashkë me kuponin fiskal, Shiqohen 6 foto të ultrazërit bashkë me dy kupona fiskal, lexohen 7 kupona fiskal, dëftesa për R.M në vlerë prej 10 euro, plotësimi i ekspertizës financiare punuar nga eksperti V.L, vendimi me nr. 1465 i

dt. 20.11.2023, aktvendimi me nr. 734 i dt. 10.07.2023, aktvendimi me nr. 534 i dt. 23.06.2023 dhe deklarimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqës.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku në lidhmëni me njëra tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje juridiko – kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se pala paditëse Agron Tigani tek e paditura ka qenë i punësuar në pozitën e Inxhinier për mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit planifikimin e projekteve, mbikqirje të grupeve dhe mirëmbajtje të kanalizimit, me kontratë me afat të caktuar prej 6 muajsh.

Gjithashtu mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se pala paditëse R.M tek e paditura ka qenë i punësuar në pozitën e Kordinatorit për KPF (ujo të pa faturuar) dhe raportim, me kontratë me afat të caktuar prej 6 muajsh.

Kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse ishte fakti nëse janë respektuar procedurat për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së palëve paditëse, nëse me rastin e punësimit të tyre janë respektuar apo jo procedurat e rekrutimit.

Përmes vendimi për caktimin e të punësuarve në vend tjetër të punës për paditësin e par sipas kontratës me numër protokollit 702 të datës 30.06.2023, dhe për të paditësin e dytë sipas kontratës me numër protokollit 751 të datës 12.09.2023, gjykata vërtetoi faktin se pala e paditur, përmes këtyre kontratave, të punësuarit – këtu paditësit kishin marrur pozitën te cekura si në kontratat e latëcekura e ku në bazë të këtyre kontratave të njëjtat këto pozita ishin me afat të caktuar dhe atë nga data 03. Korrik 2023 deri me datë 31 dhjetor 2023, ku paga mujore për paditësin e parë Agron Tiganin ka qenë 800 euro në muaj ndërsa për paditësin e dytë ka qenë 750 euro në muaj. Ku këto kontrata ishin lidhur duke u bazuar në nenin 10 par. 2 pika 2.1 dhe 2.2, nenit 11 dhe 12 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212.

Nga rekomandimi i dt. 16.08.2023 me numër 42, vërtetohet fakti se Bordi i Drejtorëve i të paditurës, kishte rekomanduar që të Anulohen procedurat e përzgjedhjes së ish zyrtarëve të lartë nga ana e kryeshefit ekzekutiv, dhe ishte Rekomanduar që të Shfuqizohen vendimet e kryeshefit ekzekutiv të KRU H sh.a., në mes e të cilëve ishin dhe vendimet për paditësin vendimi nr. 701/23 i datës 30.06.2023 për caktimin e paditësit A.T në pozitën Inxhinier për mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit, dhe vendimi me numër 750/23 i datës 12.07.2023, ku paditësi i dytë R.M ishte caktuar në pozitën Kordinator për UPF, dhe të ndërpriten kontratat e punës nr. 701/23 i datës 30.06.2023 e lidhur me A.M dhe kontrata nr. 751/23 i datës 12.07.2023, e lidhur me R.M.

Më tutje, me vendimet me numër 954 dhe 955 të datës 18.08.2023, u vërtetua se pala e paditur, paditësve i kishte ndërprerë marrëdhënien e punës, ashtu me anë të këtyre vendimeve ishin Anuluar Vendimet nr. 750/23 i datës 12.07.2023, dhe vendimi me numër 710/23 i datës 30.06.2023, duke i ndërprerë kontratën e punës me nr. 671/23 e dt. 27.06.2023, ku nderprehen

kontratat me numër protokolli 702 të datës 30.06.2023, dhe për të paditësin e dytë sipas kontrata me numër protokolli 751 të datës 12.09.2023. Këto vendime ishin marrë nga kryeshefi ekzekutiv i ndërmarrjes z. D.C, e i cili vendim kishte ardhur sipas rekomandimit të bordit të drejtorëve.

Palët paditëse, të pakënaqura me vendimin e të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kishin ushtruar ankesë me dt. 28.08.2023 numër 1013 dhe 1014, drejtuar KRU H Sh.A. kryeshefit ekzekutiv D.C.

Sipas propozimit të palës paditëse gjykata ka vendosur që të nxjerrët një ekspertiza financiar të datës 01.01.2024 e përpiluar nga ekspertja V.L, e cila në përmbajtjen e sa kishte pasqyra – llogarive bankare dhe duke e llogaritur edhe pagat e pa paguara për të dy paditësit dhe atë për një pjesë të muajt gusht dhe muajin e 09, 10, 11, 12,2024, dhe me plotësimin e ekspertizës. Eksperti kishte paraqitur ekspertizën, ashtu që duke iu përgjigjur detyrave të tij të dhëna në aktvendim, kishte përpiluar këtë ekspertizë sipas dy varianteve, ashtu që sipas variantit të parës, si detyrë ka qenë që të përcaktohet se sa ka qenë paga e paditëses konkretisht baza dhe shtesat deri me përpilimin e ekspertizës dhe varianti i dytë, dy fishi i pagave.

Lidhur me këtë pikë, eksperti ka konstatuar se Paditësin A.T kishte caktuar se pagat e pa paguara neto janë 3,479.57 euro kontributi pensional nga i punsuari që duhet ti paguhet trustit është 197.10 euro, kontributi pensional nga punëdhënësi që duhet të paguhet trusti pensional është 197.10euro, dhe Tatimi në pagë qe duhet ti paguhet Buxhetit të Kosovës është 265.39 euro, ndërsa sipas variantit të dytë me dyfishin e pagave për paditësin A.T kishte caktuar se pagat e pa paguara neto janë 6,959.15 euro kontributi pensional nga i punësuarit që duhet ti paguhet trustit është 394.20 euro, kontributi pensional nga punëdhënësi që duhet të paguhet trusti pensional është 394.20 euro, dhe Tatimi në pagë qe duhet ti paguhet Buxhetit të Kosovës është 530.78 euro.

Ndërsa për paditësin e dytë R.M kishte caktuar se pagat e pa paguara neto janë 3,382.09 euro, kontributi pensional nga i punësuarit që duhet ti paguhet trustit është 191.40 euro, kontributi pensional nga punëdhënësi që duhet të paguhet trusti pensional është 191.40euro, dhe Tatimi në pagë qe duhet ti paguhet Buxhetit të Kosovës është 254.70 euro, ndërsa sipas variantit të dytë me dyfishin e pagave për paditësin R.M kishte caktuar se pagat e pa paguara neto janë 6,764.18 euro, kontributi pensional nga i punësuarit që duhet ti paguhet trustit është 382.80 euro, kontributi pensional nga punëdhënësi që duhet të paguhet trusti pensional është 382.80 euro, dhe Tatimi në pagë qe duhet ti paguhet Buxhetit të Kosovës është 509.54 euro,

Ndërsa në emër të sigurimit shëndetësor për të dy të paditësit ishte shuma prej 138.75 euro. E ku sipas kërkesës së paditësit të dytë R.M ku i njëjti gjatë kësaj periudhe kishte nevojë për tretman mjekësor dhe se si pasoj e shikëputjes së kontratës nuk kishte pasur mundësi të i shfrytëzonte benifitet e sigurimit shëndetësor dhe si provë kishte bashkangjitur kuponat fiskal me anë të cilëve vërtetohet fakti se të njëjti i është dashur të kompensoj shumat e paguara.

Gjykata ne seancën e datës 28.02.2024, kishte ftuar ekspertin në sqarim lidhur me ekspertizën dhe plotësimin e ekspertizës ku i njëjti kishte sqaruar edhe rritjen e shumave nga

ekspertiza dhe plotësimi i saj se ne ekspertizën e parë nuk është përlogaritur përvoja e punës prej 0.5% e që është dashur të përfshihet.

Gjykata ekspertizës financiare, i ka falur besimin në tërësi, pasi që e njëjta është përpiluar konform detyrave të dhëna nga gjykata, ka përmbajtur informata të mjaftueshme e të cilat ekspertja i ka sqaruar dhe në shqyrtim gjyqësor, duke dhënë sqarime shtesë. Duhet shtuar se edhe të autorizuarit e palëve nuk kishin vërejtje në këtë ekspertizë.

Fillimisht, gjykata thekson se në këtë çështje si ligj i aplikueshëm është Ligji Nr. 03/L-212 i Punës, i cili është në fuqi nga data 16.12.2010. Sipas këtij ligji, konkretisht nenit 78 par. 1. *“I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura, par.2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. Par. 3. Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh”.*

Me neni 79 të Ligjit të Punës, është parapare mundësia e të punësuarit që të atakojë vendimin përfundimtar në gjykatë *“Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente”.*

Kurse në neni 80, të Ligjit të Punës, janë të përcaktuara kompetencat e gjykatës në rastin kur konstaton se marrëdhënia e punës është ndërprerë në mënyrë të kundërligjshme/ Vendosja gjyqësore lidhur me ndërprerjen e kontratës së punës 1. *“Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre dëmshtëpërblimeve: 1.1. t'i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shuma të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshtëpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit..”*

Neni 71 Koha e njoftimit për ndërprerjen e kontratës së punës 1. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës në kohë të pacaktuar në bazë të nenit 70, të këtij ligji ne këto intervale kohore të njoftimit: 1.1. prej gjashtë (6) muaj deri në dy (2) vite punësim, tridhjetë (30) ditë kalendarikë 1.2. prej dy (2) deri në dhjetë (10) vite punësimi, dyzetepesë (45) ditë kalendarikë 1.3. mbi dhjetë (10) vite punësim, gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike.

Gjykata, duke u nisur nga fakti se në mes të palëve ishte i pa kontestuar fakti se paditësit kishte të themeluar marrëdhënie pune me të paditurën, një rrethanë të tillë e mori si fakt të pohuar por edhe që vërtetohej përmes kontratave të cilat u administruan si prova.

Për gjykatën, po ashtu është fakt i pa kontestuar se pala e paditur, paditësit i kishte caktuar në një vend tjetër të punës, pra në atë të Inxhinjerit për mirëmbajtjen e kanalizimeve dhe koordinator për UPF, e ku më pas edhe i kishte ofruar kontratë të punës për këto pozita me afat të caktuar, nga data 01.07.2023 e deri me dt. 31.12.2023. Në kuptim të kësaj, gjykata thekson se me anë të ndërrimit të pozitive nuk është ndjekur asnjë lloj procedure rekrutuese nga pala e paditur. Mirëpo, një gjë e tillë, edhe nëse sipas palës së paditur është dashur që të ndjekë, në këtë rast është në tërësi e parëndësishme për palën paditëse, ngase e njëjta nuk ka mundet që të dëmtohet si rezultat i mos respektimit të procedurave të brendshme të paditurës e qe e njëjta ka qen e obliguar të i ndjek. Tutje, gjykata sqaron se në këtë procedurë, nuk ka qenë objekt shqyrtimi ligjshmëria e vendimit të palës së paditur kur paditësit i ka caktuar në vendin e punës, por objekt shqyrtimi ka qenë ligjshmëria e vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës se palës së paditur. Nëse e paditura ka konsideruar se vendimi i saj për caktimin e paditësve në një vend tjetër të punës ka qenë i kundërligjshëm, atëherë ajo është dashur që të ndjekë procedurat ligjore për anulimin e vendimit të tillë, e jo në mënyrë arbitrare, pa respektuar as edhe një procedurë të vetme ligjore, të i ndërpresë paditësve marrëdhënien e punës.

Me këtë rast, gjykata thekson se vendimet e atakuar nga ana e paditësve, me të cilat iu është ndërprerë marrëdhënia e punës, si të tillë janë të kundërligjshëm, nga shkak se për palët paditëse, marrëdhënia e punës të cilën e kanë themeluar, ka krijuar pritshmëri legjitime tek të njëjtit se kjo marrëdhënie e themeluar, është konform dispozitave ligjore.

Vendimet me numër 954 dhe 955 të datës 18.08.2023, janë të kundërligjshëm për disa arsye, ku fillimisht këto vendime kanë ardhur pa u respektuar afatet ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nga neni 71 i Ligjit të Punës. Pra gjykata sqaron për palët në procedurë se marrëdhënia e punës, në momentin në të cilin krijohet, pas vetes tërheq të drejta dhe obligime, andaj pala e paditur nuk mundet që të arsyetohet se nuk është respektuar procedura e rekrutimit, andaj edhe i ndërpritet marrëdhënia e punës paditësve. Kur paditësit kanë themeluar këtë marrëdhënie pune, në fakt kur janë caktuar në një detyrë tjetër nga ajo që kanë pasur, kanë lidhur edhe kontratën e reja të punës me afat të caktuar, në periudhë prej 6 muaj. Gjykata me këtë rast thekson se tek marrëdhënia e punës e themeluar me afat të caktuar, si afat për njoftim për ndërprerje të marrëdhënies së punës është periudha prej 30 ditësh, e të cilën nuk e ka respektuar e paditura, e të paktën gjykatës nuk i është ofruar një dëshmi e tillë, e se është kështu vërtetohet edhe përmes provave materiale, ngase vendimi për ndërprerje të punës ka ardhur menjëherë pas rekomandimit të bordit të drejtorëve.

Tutje, vendimet e atakuara, nuk përmbajnë asnjë nga arsyet nga neni 70 i Ligjit të Punës, pra palët paditëse nuk kanë kryer asnjë shkelje të detyrave të punës e as që është iniciuar ndonjë procedurë disiplinore ndaj tyre.

Pala e paditur, edhe pse lidhur me ankesën e paditëses kundër vendimit të atakuar, ka pranuar ankesën, për një gjë të tillë nuk ka vendosur fare, e si rrjedhojë, paditësja brenda afatit ligjor i është drejtuar gjykatës me padi.



Sa i përket lartësisë së kontestit, me të cilën gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, ka vepruar në këtë mënyrë duke u bazuar në nenin 80 të Ligjit të Punës. Gjykata në interpretim të këtij neni sqaron, se kjo dispozitë ligjore, është dispozitë autorizuese për gjykatën, kur e njëjta gjen se ndërprerja e marrëdhënies së punës është bërë në mënyrë të kundërligjshme. Bazuar në këtë nen, gjykata ka gjetur se ndërprerja e marrëdhënies së punës është bërë në mënyrë të kundërligjshme, andaj palës së paditur i bie barra e kompensimit për paditësit, për ndërprerjen e kundërligjshme të marrëdhënies së punës. Gjykata thekson se kjo dispozitë ligjore nuk flet në mënyrë eksplicite për paga, mirëpo flet për kompensim, shtesa dhe shuma të tjera të cilat i takojnë punonjësve në bazë të ligjit, kontratës së punës, aktit të brendshëm dhe kontratës kolektive.

Se çfarë është kompensim, gjykata me këtë rast vlerëson se kemi të bëjmë me pagën të cilën e ka realizuar pala paditëse në momentin e marrëdhënies së punës, të paraparë me nenin 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës, kurse shtesa dhe shuma të tjera janë ato të cilat punëmarrësi i ka realizuar në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Ashtu siç edhe është vendosur në pjesën aprovuese të kërkesëpadisë, gjykata ka gjetur se paditësve në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës si pagë bazë, paditësi i par ka pasur pagë mujore në shumë prej 800 euro ndërsa, paditësi i dytë ka pasur pagë mujore prej 750 euro. E ku paditësit nuk janë paguar për një pjesë të muajit gusht, dhe muajt shtator - dhjetor.

Duke qenë se neni 80 për gjykatën paraqet dispozitë autorizuese, gjykata atëherë bazuar në frymën e kësaj dispozite dhe të vetë Ligjit të Punës, ka gjykuar si në pjesë aprovuese, duke llogaritur pjesën e pagave të cilat do të i realizonin paditësit sikur mos ti ndërpritej marrëdhënia e punës kundërligjshëm, dhe të njëjtat i ka llogaritur jo më pak se dyfishin e të gjitha këtyre kompensimeve, përkatësisht e ka llogaritur dyfishin e pagave, që në këtë rast paraqitet si kompensim për paditësit.

Gjykata ka vepruar në këtë mënyrë, ngase neni 80 gjykatës i jep tagrin që të gjykojë shuma të tilla të cilat i konsideron të drejta dhe adekuate. Kjo dispozitë ligjore, në fakt qëllimin e saj e ka tek kompensimi i punëmarrësit për ndërprerjen e kundërligjshme të marrëdhënies së punës, pra e njëjta jepet në formën e kompensimit, dhe nuk ka për qëllim në asnjë mënyrë dëmtimin e palës së paditur e pasurimin e paditësve. Vetë shprehja e ligjit, na jep të kuptojmë se gjykata në rast të gjetjes se vendimi është i kundërligjshëm, e urdhëron punëdhënësin të ekzekutoj ndonjërin prej dëmshpërblimeve të parapara në par.1.1 dhe 1.2 të nenit 80 të Ligjit të Punës.

Se pse gjykata e ka llogaritur një kompensim të tillë në dyfishin e kompensimit, është për faktin se një shumë e tillë konsiderohet adekuate dhe e drejtë dhe se paraqet një satisfaksion për paditësit. Kjo shumë e gjykuar si në pjesën aprovuese, është e drejtë edhe për faktin se paditësit tek e paditura kanë më shumë se nga 10 vite përvojë pune, fakt që vërtetohet përmes llogarisë së trustit pensional.

Edhe pse kjo dispozitë ligjore gjykatën nuk e kufizon sa i përket lartësisë së kompensimit të cilën gjykata e konsideron si të drejtë mirëpo e vendos një minimum nën të cilin gjykata nuk

mund të bije, ashtu që gjykata me këtë rast ka marrë parasysh kërkesën e palës paditëse të cilët me anë të parashtrës së datës 01.03.2024, kishin parashtruar dy kërkesa ose kthimin në vendin e punës ose pagesën e dy pagave e për çka gjykata ka konstatuar se palët paditëse nuk kanë bazë ligjore për kthimin në vendet e tyre të punës për arsye se kontratat e punës kanë qenë me afat të caktuar kohor dhe at deri me datë 31.12.2023, në këtë mënyrë gjykata ka qenë e kufizuar dhe ka akorduar vetëm dyfishin, e kjo duke u bazuar në nenin 255 par. 3 dhe nenin 2.1 të LPK-së “Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse.”

Vendimtare në këtë çështje kontestimore për vendosje gjykata kishte fatin nëse pala e paditur ka ndjekur procedurën e paraparë ligjore për ndërprerjen e punës për paditësit, e që nga provat e administruara si më lartë, u vërtetua se pala e paditur nuk ka ndjekur procedurën e paraparë me ligj, kurse sa i përket lartësisë së kontestit, kjo u vërtetua përmes ekspertizës financiare të ekspertit V.L.

Gjykata vendosi si në dispozitiv për pjesën refuzuesi për sigurim shëndetësor duke pasur parasysh se sigurimi shëndetësor paguhet për punëtorët dhe atë për periudhën të cilën janë në marrëdhënie pune dhe kjo shumë i paguhet Kompanisë së Sigurimeve dhe ky benefit nuk i takon palës së paditur si kompensim, pasi që mbi bazën e kontratës së sigurimit shëndetësor ky raport është mes këtu të paditurës dhe Kompanisë së Sigurimit pra kjo shumë nuk i takon palëve paditëse gjithashtu sa i përket kërkesës së paditësit R.M për kompensimin e shpenzimeve të mjekimit që i janë krijuar gjatë periudhës të cilës i është shkëputur marrëdhënia e punës gjykata nuk i fali besimin të njëjtave pasi që pala paditëse nuk ka prezantuar prova me anë të cilave do të vërtetohet fakti se ky lloj i kompensimit për shpenzimet e mjekimit a mbulohet nga Kompania e Sigurimeve pasi që në shkresat e lendes nuk ka pasur dheshmi siç është kontrata e sigurimit shëndetësor dhe kjo ka qenë detyrë e palës paditëse ti dorëzojë gjykatës këtë kontratë në kuptim të nenit 322 paragraf 1 dhe 2 e lidhur me neni 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së, e në anën tjetër gjykatës i ka munguar autorizimi që të nxjerr prova sipas detyrës zyrtare sepse me nenin 7 paragraf 2 të LPK-së, përcaktohet se: “ Gjykata mund të kërkojë nxjerrjen e provave sipas detyrës zyrtare, për vërtetimin e fakteve edhe pse palët nuk i kanë propozuar, vetëm nëse ato prova po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht të përcaktuara në kuptim të nenit 3 paragraf 3 të LPK-së ”.

Gjykata vendosi si në pikën V të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e refuzuar kërkesën për kthim në punë e cila një hatrit ka qenë edhe kërkesë alternative e palëve paditëse edhe pse vendimet janë anuluar, për të vendosur në mënyrë të tillë, gjykata pati parasysh nenin 80 par.1 pika 1.1 dhe 1.2 Ligjit të Punës, e në të cilin parashihet se kur konstatohet se punëmarrësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës në mënyrë të kundërligjshme, atëherë do të urdhërojë që punëdhënësi t’ia paguajë punëmarrësit kompensimin por assesi nuk ka tagër që të detyrojë punëdhënësin që punëmarrësin ta kthejë në punë... ose nëse ndërprerja e punës është si rrjedhojë e diskriminit e paraparë në nenin 5 të këtij ligji, atëherë do të urdhërojë kthimin në punë

Sa i përket pretendimeve të autorizuarit të palës së paditur, gjykata ka vlerësuar pretendimet e të njëjtës, por i ka marrë në tërësi të pa bazuara, dhe me qëllim të shmangies së përgjegjësive të tyre, ngase është vërtetuar se të njëjtit nuk kanë respektuar procedurën ligjore dhe atë të paraparë me rregulloret apo aktet e tyre të brendshme për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Pala e paditur, pretendimin e saj kryesor e kishte në drejtim të asaj se nuk janë respektuar procedurat ligjore, konkretisht neni 8 i Ligjit të Punës, për themelimin e marrëdhënies së punës, mirëpo ashtu siç është arsyetuar më lartë, një gjë e tillë nuk është objekt shqyrtimi, ngase e paditura ka mundur që të atakojë vendimin me të cilin paditësja ka themeluar marrëdhënie punë, e që nuk ka bërë një gjë të tillë, kurse themelimi i marrëdhënies së punës, pas vetes tërheq të drejta dhe obligime, e të cilave palët janë të obliguar që të i'u përmbahen.

Vlenë të theksohet nga të lartcekurat dhe provat e administruara pala e paditur me asnjë provë nuk ka argumentuar se kanë përfillur procedurat por të njëjtit vetëm në aspektin deklarator e kanë kundërshtuar padinë dhe kërkesën e saj edhe pse kjo ka qenë detyrë e tyre, në kuptim të nenit 322 paragraf 1 dhe 2 e lidhur me neni 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së, e në anën tjetër gjykatës i ka munguar autorizimi që të nxjerr prova sipas detyrës zyrtare sepse me nenin 7 paragraf 2 të LPK-së, përcaktohet se: “ Gjykata mund të kërkoj nxjerrjen e provave sipas detyrës zyrtare, për vërtetimin e fakteve edhe pse palët nuk i kanë propozuar, vetëm nëse ato prova po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht të përcaktuara në kuptim të nenit 3 paragraf 3 të LPK-së ”.

Meqenëse të paditurat kanë rënë në vonesë në kërkesë, gjykata me kërkesën e paditësit dhe në bazë të nenit 382 par.2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, e detyroj të paditurin që paditësve në shumën e gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi t`ia paguaj edhe me kamatën ligjore 8% në vit, duke iu llogaritur nga data 27.09.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive

Vendimin që e paditura ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452, 453, e lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke mare parasysh suksesin e palës paditëse ne këtë procedurë si dhe duke u mbështetur në tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës dhe atë shumen prej 1,990,80 euro, (lartësia e shpenzimeve të procedurës i referohen shpenzimeve të përfaqësimit të autorizuarit të palës paditëse dhe atë për: përpilimin e padisë shumën prej 312 euro, shumen 312 euro për precizimin e kërkesëpadisë, për tri seanca të mbajtura për secilën nga 405.60 x 3=1.216.80 euro, dhe për ekspertizë financiare shume prej 150 euro).

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 par.1 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL**  
**2023:204998 - C.nr.2817/23, 11.04.2024**

**G j y q t a r i**  
Besnik Shala

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 dite, nga dita e pranimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.